



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:205965

Datë: 03.07.2024

Numri i dokumentit: 05893005

PKR.nr.102/2024

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Krimeve të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Gëzim Ademi dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në çështjen penale ndaj të akuzuarve: I.K. për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së dhe B.Sh., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, me shenjë PP/I.nr.24/2023 e datës 31.05.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, më datë 19.06.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Armend Hamiti, të akuzuarit I.K. me mbrojtësin të tij sipas autorizimit av. V. S. dhe të akuzuarit B. Sh., më datë 20.06.2024 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa më datë 03.07.2024 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I.K., nga i ati K dhe e ëma F, e vajzërisë A., i lindur më datë ... në fshatin A. Komuna e L., me vendbanim në lagja "A.", rruga "S. Sh." në L., me numër personal ..., me profesion elektrikist, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

B. Sh., nga i ati F. dhe e ëma G., e vajzërisë G., i lindur më datë ... në P., me vendbanim në fshati T., Komuna e L., me numër personal ..., i pa punë, i pa martuar, ka të kryer shkollën

fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

## JANË FAJTORË

I akuzuari I.K.,

Sepse:

Me datën 06.04.2022 rreth orës 16:30 në L., në lokalin “C.”, i pandehuri I.K., pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të cilat janë shpallur me ligj si substanca psikotrope apo substanca analoge, ashtu që derisa ishte në vendin e tij të punës si kamarier i ka dhënë të pandehurit B. Sh. substancë narkotike të llojit Kanabis (Marihuanë) me peshë neto të përgjithshme:  $0.50 \pm 0.0001$  gram.

Me këtë ka kryer veprën penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së.

I pandehuri B. Sh.,

Sepse:

Me datën 06.04.2022 rreth orës 16:30 në rr. “L. e P.” në L., mbrapa kafiterisë “G.P.”, në parking, i pandehuri B.Sh., pa autorizim ka poseduar substancë narkotike, ashtu që derisa ishte së bashku me shokun e tij – dëshmitarin A. S., njësitë policore i kanë ndalë dhe gjatë kontrollimit në trupin e tyre, të pandehurit B.Sh. i janë gjetur një sasi e substancës narkotike të llojit Kanabis (Marihuanë) me peshë neto e përgjithshme:  $0.50 \pm 0.0001$  gram.

Me këtë ka kryer veprën penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269, par. 1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të neneve 1, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 48, 69, 70, 71, 72, 267 par 1 dhe 269 par 1 të KPRK-së dhe neneve 364, 365 dhe 449 të KPPRK-së, të akuzuarit i:

## G J Y K O N

Të pandehurin I.K.,

Dënim me burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në kohe të verifikimit prej 2 vite.

Dënim me gjobë në shumë prej 2,000.00 € (dy mijë) euro, të cilën gjobë është i obliguar ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

Të pandehurit B.Sh.,

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në kohe verifikimi prej 1 viti.

Dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind) euro, të cilën gjobë është i obliguar ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

Gjykata, në mbështetje të nenit 276 par.1 dhe 2 të KPPRK-së dhe neneve 267 par.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ndaj të pandehurit lëshon këtë urdhër: URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i sendeve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si në vijim: Substanca narkotike e llojit Kanabis (marihuanë), Tetrahidrokanabinol (THC), pesha neto e përgjithshme 0.50 gram nga i pandehuri B.Sh..

URDHËROHET Policia e Kosovës që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin (asgjësimin) e sasisë së lartpërmendur të substancës narkotike.

Obligohen të pandehurit, t'i paguajnë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën secili veç e veç nga 50 Euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën secili veç e veç nga 50 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

## A r s y e t i m

### *Rrjedha e procedurës:*

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.24/2023 e datës 31.05.2024, ndaj të pandehurve I.K. për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së dhe B.Sh., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së.

Gjykata, për këtë lëndë penale ka caktuar dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 19.06.2024, në të cilën kanë marrë pjesë Prokurori i Shtetit, i akuzuari I.K. me mbrojtësin e tij av. V. S. dhe i akuzuari B.Sh., ku të akuzuarit pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, e kanë pranuar fajësinë.

I akuzuari I.K. ka deklaruar se e ndien veten fajtor për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së dhe se i vjen keq për rastin që ka ndodhur, është hera e parë që kam rënë në kundërshtim me ligjin dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepër penale. I ka propozuar gjykatës që t'i shqiptoj një dënim me kusht ose eventualisht dënimin me burg t'ia zëvendësojë me dënim me gjobë.

I akuzuari B.Sh. në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e ndien veten fajtor për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, e cila i vihet në barrë, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepër penale, është penduar shumë për këtë vepër penale dhe që nga ajo kohë më nuk ka përdor substancë narkotike. I ka propozuar gjykatës që të shqiptojë një dënim sa më të butë, pasi që është i gjendjes së dobët ekonomike.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, gjykata ka kërkuar mendimin e Prokurorit të Shtetit i cili ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe konsideroj se ky pranim i fajësisë është konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPRK-së, ky pranim i fajësisë është në përputhje të plotë me provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës, i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, e cila aktakuzë nuk ka shkelje ligjore,

ashtu që Prokuroria pajtohet me këtë pranim të fajësisë dhe gjykata ta merr si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit.

Mbrojtësi i te pandehurit I.K., av. V.S., lidhur me deklarin e pranimin te fajësisë nga i mbrojturi i tije deklaroi se: me të mbrojturin tim kam biseduar dhe ia kam sqaruar pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë në gjykatë, i mbrojturi im me vullnet të lirë dhe vetëdije të plotë ka shprehur gatishmëri ta pranojë fajësinë në këtë shqyrtim fillestar. Andaj, konsiderojmë se ky pranim i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës, është bërë konform dispozitave ligjore dhe gjykatës i propozojmë ta aprovojë këtë pranim të fajësisë. Gjykatës i propozojmë që të mbrojturit tim t'i shqiptojë një dënim sa më të butë që është e mundur dhe atë, nën minimumin ligjor: dënim me burg deri në 6 muaj, i cili dënim do të zëvendësohej me dënim me gjobë me pëlqim të mbrojturit tim dhe dënim me gjobë ose ndonjë dënim me kusht. Andaj, duke i pasur parasysh këto rrethana lehtësuese si: bashkëpunimi dhe sinqeriteti i të mbrojturit tim në procedurën paraprake dhe në shqyrtim fillestar, pranimi i fajësisë, fakti që është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, ka qenë i moshës rreth 20 vjeçare kur e ka kryer këtë vepër penale, pra ka qenë i ri, i mbrojturi im në atë kohë nga mendjelehtësia e tij ka përdorur substanca narkotike edhe personalisht, tani më që nga ajo kohë, i njëjti nuk është duke përdorur substanca të tilla, i premtori gjykatës se më nuk do të kryejë vepër penale dhe kjo ka qenë vepra penale e vetme e tij.

#### *Vlerësimi i Gjykatës:*

Gjykata konstaton se të akuzuarit e pranojnë fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, të akuzuarit janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimin te fajësisë për të cilat është njoftuar nga Gjykata, si dhe te gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 te KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që, gjykata aprovon deklarin për pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarve.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarinin të akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata vërtetoi se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve mbështetet në provat me të cilat gjenden në shkresat e lëndës si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2022-AH-0382 i datës 06.04.2022, Procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin A. S. i datës 06.04.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje për të pandehurin I.K. në prezencë të mbrojtësit të tij dhënë në Prokurori me datë 15.02.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje për të pandehurin B.Sh. dhënë në Prokurori me datë 15.02.2024, Formulari i dëshmisë mbi sekuestrimin e substancës narkotike i datës 06.04.2024 nga i dyshuari B.Sh., Raporti i ekspertimit nga Agjensioni Kosovar i Forenzikës me numër AKF/2024-1017/24-972 i datës 17.05.2024. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale që iu vihen në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në mënyrë vullnetare, se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja se pas pranimit të fajësisë, nuk mund të bëjnë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga të akuzuarit.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të akuzuarve dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale I.K. për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së për të cilën veprë është paraparë dënim me gjobë dhe dënim me burgim dy (2) deri në tetë (8) vite burgim dhe B.Sh., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, për të cilën veprë penale është paraparë dënim me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

*Caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimit:*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69, të KPRK-së.

Gjykata, rrethana rënduese në rastin konkret nuk gjeti. Ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata e vlerësoi pranimin e fajësisë në tërësi për veprat penale, rrethanë kjo lehtësuese e përcaktuar nga vetë ligji sipas nenit 71, par. 1.3, të KPRK-së, faktin se të njëjtit kanë shprehur keqardhje dhe janë penduar për ndodhjen e rastit, pastaj faktin se nga fillimi i procedurës penale kanë bashkëpunuar me organet e ndjekjes, janë të moshës së re, kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra penale dhe se është hera e parë që kanë rënë ndesh me ligjin.

Gjykata, sa i përket dënimit me burg, në kuptim të nenit 71, të KPRK-së ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke u bazuar në faktin se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë dhe se pranimi i fajësisë është rrethanë ligjore, në kuptim të nenit 71, par. 1, nën par. 1.3, të KPRK-së, për zbutjen e dënimit, respektivisht që gjykata të shqiptojë dënim nën minimumin e dënimit të paraparë për këtë veprë. Megjithatë, me rastin e zbutjes së dënimit janë respektuar kufijtë e zbutjes sipas nenit 72, par. 1, nën par. 1.4, të KPRK-së, që në rastet e tilla, kur minimumi i dënimit për veprën penale është 2 vjet, dënimi mund të zbutet deri në 6 muaj, çka në rastin konkret Gjykata ka shqiptuar dënim për të pandehurin I.K. 12 muaj burgim me kusht dhe dënim me gjobë në shumën prej 2,000.00 Euro, ndërsa për të pandehurin B.Sh. dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj me kusht si dhe dënim me gjobë në shumën prej 300 Euro. Meqenëse i pandehuri I.K. ka pranuar fajësinë, gjykata ka zbatuar dispozitën e nenit 71, paragrafi 1.3 për zbutjen e dënimit, e me rastin e zbutjes së dënimit, gjykata ka shqiptuar dënim me kusht, duke i respektuar kushtet për shqiptimin e dënimit me kusht nga neni 49, paragrafi 2 të KPRK-së, pasi që vepra penale ka qenë e dënueshme për mbi pesë vite.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana, si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore gjykata të pandehurve u shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi, i paraparë sipas nenit 38, të KPRK-së, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, dhe nga të gjitha këto ka konsideruar se dënim i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të pandehurin.

*Konfiskimi i sendeve:*

Gjykata, si në dispozitiv të Aktgjykimit, ka urdhëruar marrjen e sendit, respektivisht substancës narkotike, duke marrë për bazë sigurinë juridike po ashtu të njëjtat janë sende që janë rezultat i kryerjes se veprës penale siç vërtetohet më lartë, në mbështetje të nenit 276, par.5 të KPPRK-së, ku përcaktohet se kimikatet, fabrikat, pajisjet laboratorike apo substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga nenet 267-274, të Kodit Penal, i nënshtrohen automatikisht konfiskimit pa marrë parasysh edhe gjetjet e gjyqtarit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.

*Shpenzimet e procedurës:*

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, par.2, pika 2.6, të KPPRK-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39, par.3, të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

*Kërkesa pasurore juridike:*

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 462, të KPPRK-së, pasi që një kërkesë e tillë nuk ishte parashtruar.

Andaj, gjykata, duke u bazuar me neni 364, 365 dhe 449 të KPPRK-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.



GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Krimeve të Rënda

PKR.nr.102/2024, datë 03.07.2024

Bashkëpunëtori profesional,  
Albrim Kastrati

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,  
Gëzim ADEMI

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa, i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.